



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 1503 Prot.

Tiranë, më 28/05/2025

URDHËR

Nr. 24, datë 28/05/2025

PËR

**SHPLLJEN E FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE PËRCAKTIMIN E
DATËS SË ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 39, pika 1, si dhe Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës" neni 5, pika 5,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për disa autoritete drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës si më poshtë:
 - a) Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike;
 - b) Drejtues i Departamentit të Inxhinierisë së Mjedisit në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit;
 - c) Drejtues i Departamentit të Hidraulikës dhe Hidroteknikës në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit;
 - d) Drejtues i Departamentit të Tekstilit dhe Modës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike;
 - e) Drejtues i Qendrës së Gjuhëve të Huaja në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike.
2. Data e fillimit të procesit zgjedhor për disa autoritete drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, është data 30.05.2025 dhe data e zhvillimit të zgjedhjeve është 30.06.2025.
3. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Akli Fundori

